

## **RREGULLORE**

**PËR REALIZIMIN E MODULEVE TË PËRGATITJES PROFESIONALE, NË KUADËR TË PROGRAMIT TË EDUKIMIT TË KANDIDATËVE PËR AUDITUES LIGJOR PRANË INSTITUTIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)**

### **Neni 1**

#### **Baza Ligjore**

Rregullorja për zbatimin e programit të edukimit të kandidatëve për titullin profesional “Auditues Ligjor”, mbështetet në:

- Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” (i ndryshuar),
- Rregulloren e Edukimit dhe Zhvillimit të Vijueshëm e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, Vendimin Nr. 134, datë 20.06.2018, si dhe
- në vendimin e Këshillit Drejtues të IEKAs (Nr 37 datë 20.09.2017) për miratimin e kurrikulës së profesionit të Audituesit Ligjor.

### **Neni 2**

#### **Objekti i Rregullores**

2.1 Kjo rregullore është hartuar për zbatimin e programit të përgatitjes profesionale sipas kurikulës së profesionit të Audituesit Ligjor. Programi i hartuar në përputhje me objektivat, për përgatitjen e kandidatëve për Auditues Ligjor në Republikën e Shqipërisë, është hartuar në zbatim të ligjit Nr.10091, neni 18, me mbështetjen e projektit të Bankës Botërore “Projekti i Përmirësimit të Cilësisë të Raportimit Financiar” dhe është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 37, datë 20.09.2017.

2.2 Kjo rregullore përcakton aspektet organizative e udhëzuese për realizimin e moduleve të përgatitjes profesionale dhe për plotësimin e detyrimeve nga:

2.2.1 Kandidatët e miratuar të cilët zhvillojnë praktikën profesionale dhe ndërkohe ndjekin edukimin profesional të avancuar përmes trajnimeve, leksioneve, seminareve dhe testeve përkatëse për njohuritë e aftësitë e tyre profesionale, sipas moduleve që përmban programi.

2.2.2. Individët që kanë përfituar përjashtimin nga praktika profesionale me arsyen se mbi 15 vite kanë qënë të angazhuar në veprimtari profesionale dhe kanë fituar përvojën e mjaftueshme në fushën e kontabilitetit, auditimit, finances, legjislacionit tatimor, të cilët do të nënshtrohen të njëjtit proces testimi që i nënshtrohen kandidatët në pikën 2.2.1.

2.2.3 Individët të cilët kanë fituar titullin CPA apo ACCA në një shtet tjetër, të cilët miratohen me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues dhe do të nënshtrohen provimeve përfundimtare që organizohen nga Komisioni i Provimeve të Aftësisë Profesionale, vetëm për pjesën e programin të pambuluar nga programi i ACCA apo CPA. Këta individë mund të ndjekin edhe modulet e tjera në mënyrë vullnetare.

2.2.4 Të tjerë të interesuar në programin e përgatitjes profesionale të AL, të cilët miratohen me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

Kjo rregullore është hartuar duke respektuar lirinë akademike, si dhe të drejtat dhe detyrimet e individëve që angazhohen në cilësinë e stafit akademik e tekniko profesional dhe të kandidatëve në studimet profesionale (të llojit post master).

### **Neni 3**

#### **Shkurtesa dhe Përkufizime**

Shkurtime të përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

**IEKA** – Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

**KEKV** – Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional

**KD** – Këshilli Drejtues i IEKAs

**KM** – Kontabilist i Miratuar

**AL** – Auditues Ligjor

**ACCA** – Association of Chartered Certified Accountants

**CPA** – Certified Public Accountant

**IASB/BNSK** – International Accounting Standards Board (Board)/Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (Bordi)

**IAASB** – International Auditing and Assurance Standards Board

**IAESB/BSNEK** – International Accounting Education Standards Board/ Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit Kontabël

**SNK** – Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

**SNRF** – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

**SKK** – Standardet Kombëtare të Kontabilitetit **SNA** – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

“Kandidat” është individ, i cili është pranuar nga organizmi profesional i audituesve ligjorë, dhe është regjistruar për të kryer praktikën profesionale të përgatitjes teoriko-praktike pranë një audituesi ligjor ose një shoqërie auditimi. Individui duhet të ketë kaluar me sukses testimin hyrës, sipas kërkesave të rregullores së edukimit, si edhe të gjithë modulet e ndërmjetme të vlerësuara nga struktura e Edukimit pranë IEKAs, bazuar në një rregullore të veçantë të njohjes së rezultateve të studimeve të mëparshme pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë.

“Testim” Procesi i verifikimit të njohurive teorike e praktike dhe aftësive për të zbatuar në praktikë standardet teknike, etike dhe profesionale. Testimi zhvillohet me shkrim me një sistem pyetjesh me një shkallë vështirësie rritëse, sipas një formati dhe përmbajtje lëndore të miratuar, i cili rikonfirmohet në çdo fillim sezoni dhe ju bëhet i njohur kandidatëve.

“Provimet përfundimtare” Janë provimet që organizohen nga Komisioni i Provimeve të Aftësisë Profesionale, në zbatim të kërkesave të Ligjit 10091, i indryshuar dhe akteve nënligjore e rregullatore të nxjerra në zbatim të tij.

“Auditues Ligjor” është individ i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e ligjit 10 091, i ndryshuar.

“Kontabilist i Miratuar” është personi fizik, profesionist i lirë, i regjistruar në regjistrin e njëres prej organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, që kontraktohet nga personi juridik, për të kryer shërbime të kontabilitetit. Ai mund të kryejë edhe shërbime të tjera, të cilat nuk bien në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

“Organizata profesionale e audituesve ligjorë” është organizmi profesional, që grupon auditues ligjor dhe shoqëritë e auditimit që ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë. “Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar” është emërtimi i organizatës profesionale të audituesve ligjorë e cila është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr.3573, datë 16.10.1998. Ky emërtim mund të ndryshohet, në përputhje me procedurat statutoire të organizatës.

#### **Neni 4**

##### **Kushtet për regjistrimin e kandidatit**

4.1 Kandidatët që do të ndjekin studimet profesionale (post master) duhet të jenë të regjistruar në praktikën profesionale për Auditues Ligjor, në pajtim me kuadrin ligjor dhe rregullator të zbatueshëm.

Në zbatim të Ligjit 10091, i ndryshuar dhe të Rregullores së Edukimit dhe Zhvillimit të Vijueshëm, Seksioni 4.2, për t’u pranuar në praktikën profesionale kandidati duhet të plotësojë këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të mos jetë dënuar penalisht ose me dënim plotësues, të natyrës që vë në dyshim ndershmërinë e tij;
- c) të ketë fituar diplomë të shkollës së lartë, ku përfshihet:
  - i. Diplomë Bachelor (3-vjecare) së bashku me diplomën “Master” ose;
  - ii. Diplomë e integruar e nivelit të dytë ose;
  - iii. Diplomë të ekuivalentuar me (i) dhe (ii);

në çdo njërën nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to.

4.2 Në zbatim të pikës (c) të paragrafit të mësipërm, Këshilli Drejtues, vlerëson pajtueshmërinë e edukimit universitar të kandidatëve me kërkesat e parashikuara në kurrikulën e miratuar të profesionit të Audituesit Ligjor dhe përcakton disiplinat teorike të pjesës së moduleve bazë dhe të ndërmjetme të programit të plotë të edukimit për titullin Auditues Ligjor, që duhet të ndjekë kandidati përpara se të regjistrohet dhe të marrë pjesë në programin e studimeve post master.

4.3 Ndjekja e moduleve profesionale të avancuar në shkollën post master dhe hyrja më pas në provimet e aftësisë profesionale në çdo rast do të bëhet vetëm pasi të plotësohen kërkesat e parashikuara në programin e edukimit të miratuar të cilat lidhen me lëndën/disiplinat përkatëse që kërkohen në nivelet bazë dhe atë ndërmjetëm, sipas pikës 4.2.

## Neni 5

### Programi i Studimit Post Master

#### 5.1 Objektivat e Programit të Studimit post master për marrjen e titullit profesional “Auditues Ligjor”

Programi i studimit profesional post master për marrjen e titullit Auditues Ligjor synon që kandidati:

- a) Të zhvillojë aftësitë për zbatimin në praktikë të standardeve teknike, profesionale dhe etike;
- b) Të marrë njohuri të thelluara dhe të njihet me literaturën bashkëkohore në fushën përkatëse të studimit.
- c) Të pajiset me një serë njohurish profesionale e praktike në fushën e kontabilitetit, auditimit, financës dhe legjislacionit;
- d) Të arrijë një përgatitje të avancuar për formimin e aftësive, kompetencave, dhe zotësive për të kryer detyra profesionale të përgjithshme dhe specifike në mënyrë cilësore, etike dhe në shërbim të interesit publik;
- e) Të thellojë, të zgjerojë dhe të specializojë njohuritë, konceptet dhe zotësitë në lidhje me aplikimin e standardeve teknike, profesionale dhe etike të avancuara;
- f) Të gërshetojë përgatitjen teorike dhe studimore nga njëra anë dhe eksperiencën praktike nga ana tjetër.

#### 5.2 Struktura e Programit të Studimit profesional post master:

- a) Programi i studimeve post master për marrjen e titullit “Auditues Ligjor” realizohet nga dhe pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) me kohëzgjatje normale jo më pak se 3 vite kalendarike;
- b) Disiplinat dhe veprimtaritë e tjera formuese, që zhvillohen në këtë program studimi, përfshijnë modulet profesionale të një niveli të avancuar, si më poshtë:
  - 1. Moduli Raportimi Financiar i Avancuar;
  - 2. Moduli Taksimi i Avancuar;
  - 3. Moduli Legjislacioni i Biznesit i Avancuar;
  - 4. Moduli Auditim dhe Dhënie Sigurie i Avancuar
  - 5. Moduli Drejtimi i Performancës i Avancuar
  - 6. Moduli Etika Profesionale
- c) Programi parashikon zhvillimin e deri dy moduleve profesionale në vit. Kandidati mund të ndjekë të pavarura nga njëra- tjetra, secilin nga modulet në pikat 1, 2 dhe 3 më sipër. Për të vijuar me modulet në pikat 4, 5 dhe 6, kandidati duhet të ketë përfunduar më parë me sukses ndjekjen e tre moduleve të para, si dhe detyrimet përkatëse për këto module.
- d) Programi i studimeve post master shoqërohet me kryerjen e praktikës profesionale me kohëzgjatje normale të paktën 3 vite kalendarike, e cila vlerësohet çdo gjashtë muaj nga drejtuesi i praktikës profesionale dhe çdo fund viti nga KEKV dhe KD;

- e) Përfundimi me sukses i programit të studimit profesional, së bashku me përmbushjen e kërkesave të praktikës profesionale, i jep mundësinë kandidatit të regjistrohet për t'ju nënshtruar testeve në kuadrin e provimeve përfundimtare të aftësive profesionale për marrjen e titullit "Auditues Ligjor".

## **Neni 6**

### **Mënyra e Organizimit të Mësimdhënies**

6.1 Mësimdhënia realizohet në formën e leksioneve, diskutimeve mbi rastet praktike, seminareve dhe formave të tjera të ngjashme, që mundësojnë arritjen e objektivave të parashikuara në çdonjërin nga modulet që përfshihen në programin profesional.

a) Gjatë zhvillimit të modulit profesional përkatës, mund të përdoren metoda të ndryshme, si prezantime dhe diskutime mbi materialet e marra nga literatuara e huaj, si dhe raste studimore nga praktika vendase. Kandidatët duhet të jenë aktiv gjatë diskutimeve në klasë, dhe gjatë seancave të zgjidhjes së rasteve praktike pasi, aktivizimi i kandidatit do të jetë pjesë e vlerësimit të tij përfundimtar;

b) Material bazë për trajnimin do të jetë literatura e huaj (në gjuhën angleze), tekstet të përkthyer në gjuhën shqipe nga dhe nën udhëheqjen e IEKAs, prezantimet në powerpoint për secilin leksion, rastet studimore nga praktika vendase dhe botërore, të cilat synojnë thellimin e njohurive e njohjen e koncepteve teorike dhe zbatimin në praktikë të njohurive të marra;

c) Rastet studimore praktike do t'u japin kandidatëve mundësinë që të ushtrohen dhe të përmirësojnë aftësitë e komunikimit me shkrim ose verbal, edhe nëpërmjet prezantimeve në klasë nga vetë kandidatët;

d) Përgjegjësitë e kandidatëve për Auditues Ligjor përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- detyrimin për të njohur punën dhe përpjekjet e të tjerëve kur të dorëzohet një punim personal;
- detyrimin për të referuar qartësisht idetë, të dhënat, zgjidhjet, citimet direkte, parafrazimet apo çdo përfshirje të punës së të tjerëve;
- detyrimin për të ushtruar integritetin më të lartë kur kryejnë testimet, përfshirë detyrimin për të raportuar çdo shkelje të vënë re;

6.2 Në fillim të çdo viti akademik, kandidatëve për Auditues Ligjor ju vihen në dispozicion informacion mbi programin e studimit dhe plan programet shoqëruese të miratuara për çdo modul që do të zhvillohet.

## **Neni 7**

### **Frekuentimi**

7.1 Frekuentimi i leksioneve të moduleve profesionale është i detyrueshëm në masën 75%. Nëse kandidati frekuenton më pak se 75% të orëve të leksioneve, ai humb te drejtën për të hyrë në testimin përfundimtar të modulit përkatës. Në rastet kur, kandidati vlerësohet se nuk e ka frekuentuar mjaftueshëm modulin, përveçse nuk lejohet të hyjë në testimin përfundimtar, atij i shtyhet edhe praktika profesionale, në pajtim me ligjin dhe rregulloren e edukimit dhe zhvillimit të vijueshëm

profesional të IEKAs. Vlerësimi për shtyrjen e praktikës profesionale do të bëhet rast pas rasti nga Njësia e Edukimit të Kandidatëve, e cila bashkërendon punën me KEKV dhe Drejtorin Ekzekutiv.

7.2 Frekuentimi i seminareve dhe diskutimeve të rasteve studimore praktike është i detyrueshëm në masën 80%. Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 80% të orëve të seminareve dhe diskutimeve lidhur me rastet studimore praktike, ai nuk ka të drejtë të hyjë në testimin përfundimtar, duke u detyruar të përsëritë zhvillimin e seminareve të modulit si edhe praktikën profesionale në vitin e ardhshëm.

## **Neni 8**

### **Ç’regjistrimi**

8.1 Ç’regjistrimi i një kandidati bëhet në të gjitha rastet e parashikuara nga rregullorja e edukimit dhe zhvillimit të vijueshëm profesional.

Zhvillimi i Moduleve Profesionale të Avancuara përfundon:

- Me lëshimin e certifikatës/dëshmisë për zhvillimin e moduleve profesionale;
- Kur kandidati tërhiqet nga kryerja e praktikës profesionale;
- Kur kandidati përjashtohet nga kryerja e praktikës profesionale;
- Kur kandidati nuk kalon testet e të të njejtit modul profesional për dy vite rresht;
- Kur ndërprerja ose ndërprerjet janë në total më shumë se dy vjet.

8.2 Pasi ç’regjistrohet, kandidati pajiset me listën e moduleve të dhëna deri në datën e ç’regjistrimit, të shoqëruar me vlerësimet përkatëse si dhe programet e moduleve (në shqip dhe anglisht), pasi ka shlyer të gjitha detyrimet financiare të vitit përkatës të përcaktuara nga IEKA.

## **Neni 9**

### **Vlerësimi i Njohurive të Fituara nga Kandidatët**

#### **9.1 Sistemi i Vlerësimit**

Shkalla e përvetësimit të programit të edukimit vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota 5 (pesë) dhe nota maksimale 10 (dhjetë).

| <b>Vlerësimi</b> | <b>Pikët</b>    |
|------------------|-----------------|
| 10               | 90 – 100        |
| 9                | 82–89           |
| 8                | 74–81           |
| 7                | 66–73           |
| 6                | 58–65           |
| 5                | 51–57           |
| 4                | deri në 50 pikë |

## 9.2 Mënyra e Kontrollit dhe e Vlerësimit të Dijes

Vlerësimi i dijeve të kandidatit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm të vlerësuar me pikë (në total 100 pikë):

- a) Testimi i ndërmjetëm me shkrim (25%);
- b) Aktivizimi dhe niveli i diskutimit (5-10%);
- c) Punë individuale dhe në grup: detyra kursi, ese, prezantime, projekte, detyra praktike (15-20%);
- d) Testimi përfundimtar, me shkrim (50%);

## 9.3 Testimet

- a) Testimet e ndërmjetme dhe testimet përfundimtare zhvillohen brenda afatit të caktuar në Kalendarin e miratuar nga IEKA. Si rregull, testimet e ndërmjetme kryhen në mes të zhvillimit të modulit me kohëzgjatje normale, ndërsa testimet përfundimtare në fund të modulit;
- b) Kandidatët duhet të rezultojnë fitues në testimin e ndërmjetëm para se të futen në testimin përfundimtar.
- c) Kandidati fiton të drejtën të hyjë në testimin përfundimtar të një moduli kur ka shlyer të gjitha detyrimet që lidhen me atë modul (sipas pikes 9.2), si dhe kur ka shlyer detyrime financiare ndaj IEKAs;
- d) Format e vlerësimit përfundimtar zhvillohen sipas plan programit të çdo lënde të miratuar në fillim të vitit dhe të shpërndarë nga IEKA tek kandidatët;
- e) Hartimi i tezës së testimit, si një dokument zyrtar i formatuar me elementët përkatës kryhet në përputhje me programin e lëndës, i cili përgatitet nga stafi akademik dhe profesional i angazhuar me mësimdhënien.
- f) Datat, oraret dhe sallat e testimeve do të publikohen në faqen web [www.ieka.al](http://www.ieka.al), Rubrika Kandidatët, si dhe do tu njoftohen me email në adresat elektronike;
- g) Testimet zhvillohen me procedurë sekretimi dhe të gjithë modulet profesionale do të testohen në letër.
- h) Në njësinë e edukimit të kandidatëve të IEKAs për çdo modul së bashku me procesverbalet e notave, stafi akademik i angazhuar në zhvillimin e modulit dorëzon edhe tabelat e detajuara të vlerësimit total të kandidatëve sipas elementëve përbërës të vlerësimit;

## 9.4 Ritestimet dhe Mbartja e provimeve

- a) Kandidati, në rastin kur nuk është paraqitur ose nuk ka rezultuar fitues në testimin përfundimtar, ka të drejtë të përsërisë testimin edhe një herë gjatë vitit. Sesioni i ritestimit caktohet jo më vonë se një muaj pas datës së testimit përfundimtar. Bëjnë përjashtim vetëm ata kandidatë, të cilët nuk janë kualifikuar për të hyrë në testim, për shkak të mungesave;
- b) Rezultati i ritestimit përfaqëson 75% të vlerësimit përfundimtar, ndërsa pjesa tjetër mbartet nga vlerësimi i marrë gjatë zhvillimit të modulit (25% për punën individuale dhe në grup dhe pikët e aktivizimit);

c) Në rast se kandidati, pas sezonit të ritestimeve, nuk ka arritur të kalojë me sukses testimin përfundimtar, ai shpallet “përsëritës” dhe i shtyhet praktika profesionale. Ai mbart për çdo lëndë vetëm deri në 25% të vlerësimit total, sipas aktivizimit në seminare, detyra kursi, ese, etj;

d) Afatet dhe procedurat për vlerësimin dhe rishikimin e rezultateve do të rregullohen me rregulla të veçanta.

#### 9.5 Praktika profesionale

a) Praktika profesionale e kandidatëve është pjesë përbërëse e edukimit profesional për marrjen e titullit profesional Auditues Ligjor;

b) Praktika profesionale është e detyrueshme dhe kusht i domosdoshëm për të hyrë në provimet përfundimtare për marrjen e titullit profesional Auditues Ligjor, të cilat organizohen nga Komisioni i Provimeve të Aftësisë Profesionale;

c) Zhvillimi i praktikës profesionale realizohet në përputhje me rregulloren e Edukimit dhe Zhvillimit të Vijueshëm Profesional të IEKAs;

### Neni 10

#### Të Drejtat dhe Detyrimet e Kandidateve

##### 10.1 Të Drejtat e kandidateve

a) Kandidati ka të drejtë që të ketë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm mbi të gjitha çështjet që lidhen me studimin në modulet profesionale post master për marrjen e titullit Auditues Ligjor;

b) Të mos diskriminohet në asnjë mënyrë në të gjithë procesin e zhvillimit të leksioneve e seminareve të lidhura me modulin, si nga ana e lektoreve, kandidatëve të tjerë, ashtu dhe nga ana e organeve drejtuese dhe stafit të IEKAs;

c) Kandidati ka të drejtë që të përfitojë nga procesi i edukimit dhe të marrë dëshminë e nevojshme për të vazhduar me procesin e marrjes së titullit profesional, pasi të shlyejë detyrimet e përcaktuara në planin e moduleve të edukimit profesional dhe praktikën profesionale dhe detyrimet financiare kundrejt Institutit (IEKA);

d) Kandidati ka të drejtë të përdorë mjediset dhe pajisjet e institucionit, sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e tij shkencore;

e) Kandidati ka të drejtë të përfitojë dhe të kërkojë një vlerësim të drejtë dhe objektiv për ecurinë e tij gjatë vitit, si dhe të ankohet sipas procedurës për ankimim, kur mendon se nuk është vlerësuar drejtë dhe objektivisht;

f) Kandidati ka të drejtë të përfitojë të gjitha të drejtat që i garantojnë Statuti dhe Aktet e zbatueshme rregullatore të IEKAs;

## 10.2 Detyrimet e Kandidatëve

- a) Kandidati ka detyrimin që të njohë dhe të respektojë rregulloren e Edukimit dhe Zhvillimit të Vijueshem Profesional dhe kete rregullore, në të kundërt IEKA nuk mban asnjë përgjegjësi për pasojat që vijnë nga moszbatimi i saj qoftë edhe nga mosnjohja e saj;
- b) Kandidati ka detyrimin të njohë dhe të përmbushë në kohën e përcaktuar të gjitha kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga programi i edukimit të moduleve përkatëse;
- c) Kandidati ka detyrimin që të respektojë rregullat e etikës profesionale;
- d) Pas përfundimit me sukses të testeve në modulet profesionale, kandidati ka detyrimin të mbrojë një punim profesional, që përfshin trajtime teorike e praktike në çështje me interes për profesionin.

## Neni 11

Hartimi, Miratimi, Shpallja e Rregullores së Programit të Edukimit në modulet profesionale dhe Zbatimi

11.1 Kjo rregullore propozohet nga Njësia e Edukimit të Kandidatëve pranë IEKAs, dhe miratohet nga Këshilli Drejtues i IEKAs;

11.2 Ndryshimet/reformimet në programet e edukimit të kandidatëve bëhen me propozim të Njesisë së Edukimit të Kandidatëve pranë IEKAs (shoqëruar me relacion shpjegues mbi ndryshimet e bëra) pranë KEKV dhe paraqiten për miratim në Këshillin Drejtues të IEKAs.

11.3 Rregullorja zbatohet menjëherë pas miratimit nga Këshilli Drejtues dhe publikohet në faqen zyrtare të IEKAs ([www.ieka.al](http://www.ieka.al));

11.4 Pas kësaj, kandidati për titullin profesional Auditues Ligjor konsiderohet përgjegjës për njohjen dhe respektimin e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga kjo rregullore;

11.5 Kjo rregullore pas miratimit nga Këshilli Drejtues i IEKAs me Vendim Nr 25, hyn në fuqi sot më datë 22.07.2019

## Aneks 1

### RAPORTIMI FINANCIAR I AVANCUAR

| Dita | Tema                                                                             | Koha në orë | Rezultati i të mësuarit të programit | Kapitulli në tekstin Kaplan |
|------|----------------------------------------------------------------------------------|-------------|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1    | Përgatitja e pasqyrave financiare – kuadri rregullator Etika                     | 6           | A(i), (ii) a)<br>A(ii) b), c)        | 1<br>2                      |
| 2    | Të ardhurat                                                                      | 6           | A(ii) b), c)<br>B(i)                 | 4                           |
| 3    | Aktivet afatgjata Inventarë                                                      | 6           | A(ii) b), c)<br>B(i)                 | 5                           |
| 4    | Monedha e huaj Qiraja                                                            | 6           | A(ii) b), c)<br>B(i)                 | 6<br>7                      |
| 5    | Përfitimet e punonjësve Pagesa e bazuar në aksione                               | 6           | A(ii) b), c)<br>B(i)                 | 8<br>9                      |
| 6    | Ngjarjet pas periudhës raportuese Provizionet dhe të kushtëzuarat (kontigjencat) | 6           | A(ii) b), c)<br>B(i)                 | 10                          |
| 7    | Instrumentet financiare                                                          | 6           | A(ii) b), c)<br>B(i)                 | 11                          |
| 8    | Tatimet Palët e lidhura                                                          | 6           | A(ii) b), c)<br>B(i)                 | 12<br>14                    |
|      | <b>Testimi i ndërmjetëm 1</b>                                                    |             |                                      |                             |
| 9    | Kontabiliteti për grupin – grupet bazë                                           | 6           | C (i)                                | 19                          |
| 10   | Grupet komplekse                                                                 | 6           | C(i), (ii), (iii)                    | 20                          |
| 11   | Ndryshimet në strukturën e grupit Riorganizimet e grupit                         | 6           | C(i), (ii), (iii)                    | 21<br>23                    |
| 12   | Raportimi i performancës dhe vlerësimit të performancës Raportimi jo-financiar   | 6           | A(ii)<br>D(i)                        | 3<br>17                     |
| 13   | Raportimi i segmentuar Pajtueshmëria dhe efektiviteti i biznesit                 | 6           | A(ii)<br>D(ii)                       | 13<br>n/a                   |
| 14   | Përgatitja e pasqyrave financiare – vështrim i përgjithshëm                      | 6           |                                      | All                         |
|      | <b>Testimi i ndërmjetëm2</b>                                                     |             |                                      |                             |
| 15   | Rishikim                                                                         | 12          |                                      | 26                          |
|      | <b>Totali</b>                                                                    | <b>96</b>   |                                      |                             |

## Aneks 2

### MENAXHIMI I PERFORMANCES – NIVEL I AVANCUAR

| Dita | Tema/Moduli                                                        | Koha<br>ore | Rezultati it e<br>mesuarit te<br>programit                   | Kapitulli<br>ne<br>Tekstin<br>Kaplan |
|------|--------------------------------------------------------------------|-------------|--------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
| 1    | Planifikimi Strategjik dhe menaxhimi i performances                | 6           | A(i) a, c, f                                                 | 1                                    |
| 2    | Kontabiliteti i drejtimit strategjik dhe menaxhimi i performances  | 6           | A(i) b, d, e, g                                              | 1                                    |
| 3    | Ndikimi i mjedisit ne menaxhimin e performances                    | 6           | A(i) d, A(ii) f, h; C(ii) a, b, c                            | 2                                    |
| 4    | Rreziku dhe pasiguria<br>Buxhetimi                                 | 2<br>4      | C(i) a, b, d, e;<br>B(i) a, b, c, d, e; E(i) d               | 2<br>3                               |
| 5    | Analiza e variancave te Buxhetit<br>Parashikimi                    | 4<br>2      | B(i) f; B(ii) a, b; C(i) c                                   | 3                                    |
| 6    | Strukturat e biznesit dhe menaxhimi i performances                 | 6           | A(ii) b, c, e;<br>E(i) e                                     | 4                                    |
| 7    | Ndryshimi organizacional<br>Sistemet e Menaxhimit te informacionit | 2<br>4      | A(ii) a, b, d;<br>D(i) a, b, c, d, f, g, h;<br>D(iv) a, b, c | 4<br>5                               |
| 8    | Raportet e performances<br>Menaxhimi i burimeve njerezore          | 3<br>3      | D(i) e, h, i;<br>D(ii) a, b, c, d;<br>D(iii) e               | 6<br>7                               |
| 9    | Matesit e performances financiare te shoqerise tregtare            | 6           | D(iii) a                                                     | 8                                    |
| 10   | Matesit e performances se nendrajeve                               | 6           | D(iii) b                                                     | 9                                    |
| 11   | Matesit e performances jo-financiare                               | 6           | D(iii) c;<br>E(i) a, b, c                                    | 11<br>10                             |
| 12   | Menaxhimi i cilesise dhe kontabiliteti i menaxhimit te mjedisit    | 6           | D(iii) d                                                     | 13<br>14                             |
| 13   | Parandalimi i deshtimit te shoqerive tregtare                      | 6           | E(ii) a, b, c, d                                             | 12                                   |
| 14   | Rishikim/perseritje                                                | 12          |                                                              |                                      |
|      | <b>Totali</b>                                                      | <b>90</b>   |                                                              |                                      |

### Aneks 3

#### AUDIMI DHE SIGURIA – NIVEL I AVANCUAR

| Dita | Emërtimi i leksionit                                                                                           | Koha në orë | Rezultati i të mësuarit të programit                       | Kapitulli në Tekstin studimor Kaplan |
|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|------------------------------------------------------------|--------------------------------------|
| 1    | Rregullimi në një ekonomi globale<br>Kodi i etikës dhe sjelljes                                                | 6           | A(i) a) b) A(ii) a) b) c)<br>A(i) b) B(i) a) b)            | 1<br>2                               |
| 2    | Emërimet profesionale<br>Kontrolli i cilësisë                                                                  | 6           | C(ii) a) b) c) d) e)<br>C(i) a)                            | 3<br>4                               |
| 3    | Reklamimi, publiciteti, kryerja e punës profesionale dhe honoraret e pagesës<br>Tenderimi<br>Pastrimi i parave | 6           | C(i) b)<br>C(i) c)<br>A(iii) a) b) c) d) e)                | 5<br>6<br>7                          |
| 4    | Pergjegjësitë dhe detyrimet profesionale                                                                       | 6           | A(i) c) d) e) f)<br>B(ii) a) b) c) d)                      | 8                                    |
| 5    | Planifikimi, materialiteti dhe vlerësimi i rrezikut të anomalisë materiale                                     | 6           | B(i) c)<br>D(i) a) b) c) d) e) f)<br>D(ii) c) E(iii) a)    | 9                                    |
| 6    | Auditimet e grupit dhe ato transnacionale                                                                      | 6           | D(iv) a) b) c) d) e) f) g)                                 | 10                                   |
| 7    | Evidenca                                                                                                       | 6           | D(ii) a) b) c) e) f) g) h) i) j)                           | 11                                   |
| 8    | Procedurat e marrjes së kampionit                                                                              | 6           | D(ii) a)                                                   | 11                                   |
| 10   | Përfundimi                                                                                                     | 6           | D(iii) a) b) c) d) e) f)                                   | 12                                   |
| 9    | Raportimi                                                                                                      | 6           | F(i) a) b) c) d) f)                                        | 13                                   |
| 11   | Raportimi tek personat e ngarkuar me qeverisjen<br>Angazhime të tjera                                          | 6           | B(i) d) D(v) b) c)<br>E(i) a) b) c) d) e) f)<br>F(i) e) g) | 14<br>15                             |
| 12   | Informacionet financiare prospektive (të ardhshme)<br>Forensic audits                                          | 6           | D(v) c) F(i) g)<br>E(i) g) E(ii) a) b) c) d)               | 16<br>18                             |
| 13   | Outsourcing dhe auditimi i brendshëm<br>Auditimi i informacioneve të performancës në sektorin publik           | 6           | E(iii) b) c) D(v) a) b)<br>E(iv) a) b) c) d)               | 19<br>21                             |
| 14   | Rishikimi – Raportimi financiar                                                                                | 6           |                                                            |                                      |
| 15   | Rishikimi – Pyetje praktike                                                                                    | 6           |                                                            |                                      |
| 16   | Rishikimi – Pyetje praktike                                                                                    | 6           |                                                            |                                      |
|      | <b>Totali</b>                                                                                                  | <b>96</b>   |                                                            |                                      |